

NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe ligjit nr. 22/2018 “Për Strehim Social”, i ndryshuar, V.K.M nr. 384 datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, V.K.B nr. 136 datë 26.12.2024 “Për miratimin e fillimit të procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, për vitin 2025, Bashkia Elbasan njofton se të gjithë aplikantët që janë kualifikuar për fazën e parë dhe janë njoftuar individualisht **nga data 10.03.2025-10.04.2025** duhet të plotësojnë dokumentacionin si më poshtë:

a) Të dhëna personale të aplikantit (dokumentat provuese):

- I. f/kopje e kartës së identitetit të aplikuesit
- II. çertifikatë familjare
- III. çertifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
- IV. vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës “a”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

- I. vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes; vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje apo sëmundje e rëndë) ose force madhore;
- II. vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;
- III. vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- IV. akt verifikim nga njësia vendore për:
 - banesat në rrezik shembjeje;
 - rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.
- V. Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;

VI. akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

i) certifikatë familjare;

ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

i) vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;

ii) vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;

iii) dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;

iv) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;

v) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;

vi) urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;

vii) vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;

viii) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;

ix) vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;

x) vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë.

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës “ç”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

i) vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t’i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

ii) dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;

iii) vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;

iv) vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

v) vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Ndër të tjera për të vërtetuar situata të caktuara është e nevojshme përpos listës së mësipërme të paraqiten edhe dokumenta si më poshtë vijon:

- 1- Vërtetimin nga zyra përmbarimore për masën e pensionit ushqimor që përfiton sipas vendimit të gjykatës.
- 2- Pasqyra financiare për vitin kalendarik të shkuar për personat e vetëpunësuar e njehsuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Ekstrakt historik nga QKB.
- 3- Vërtetimi nga zyra e punësimit për personat të cilët janë regjistruar si persona punëkërkues të papunë;

Ndërkohë familjeve të cilat janë celebruar me shtetas të huaj ose individë të cilët kanë vendlindjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do t'u kërkohet vetëm dokumentacioni i siguruar nga institucionet e Republikës së Shqipërisë.

Pas miratimit të familjeve përfituese me Vendim të Këshillit Bashkiak, lista përfundimtare miratohet nga Banka përkatëse.

Dokumentacioni pranohet vetëm me postë në adresën:

Bashkia Elbasan, Lagja: “Brigada 17 Sulumese”, Rruga “O.Stafa”, Elbasan.